



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 12.06.2019
Dokument parlamentar

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.157/2013, “PËR MASAT
KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Hyrje

Në bazë të Kalendarit të Punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 5.06.2019, dhe 12.06.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit i ndryshuar”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Alket Hyseni.

Në mbledhjet e Komisionit për të diskutuar dhe paraqitur propozime për projektligjin ishin të pranishëm zëvendës ministri i Financave dhe Ekonomisë z. Elton Haxhi, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtësisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave z. Elvis Koçi dhe përfaqësues të kësaj drejtorie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. QËLLIMI DHE IMPAKTI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe ekonomisë në tërësi, nga kërcënimet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues ndaj fenomenit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Nëpërmjet kësaj nisme ligjore, synohet përafrimit të legjislacionit tonë me parashikimet e akteve të ndryshme ndërkombëtare, për sa u takon masave kundër financimit të terrorizmit dhe në të njëjtën kohë, reflektimi i rekomandimeve të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Evropës për vendin tonë. Në funksion të këtij qëllimi, shtesat dhe ndryshimet e propozuara në ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar synojnë:

- a. zvogëlimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit;
- b. parandalimin e hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë ose zbulimi dhe raportimi i tyre;
- c. zbulimin dhe goditjen e kërcënimeve për pastrim të parave/financim terrorizmi.
- d. përafrimin e kuadrit ligjor me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar.
- e. parandalimin e hyrjes së fondeve në mbështetje të terrorizmit dhe zbulimit të pasurive dhe fondeve të mbajtura nga personat e shpallur dhe ndalimet;
- f. implementimin dhe zbatimin e sanksioneve financiare specifike në përputhje me procedurat dhe standartet e Metodologjisë së FATF;
- g. implementimin pa vonesë të sanksioneve financiare specifike dhe bllokimin pa njoftim paraprak të fondeve dhe pasurive të personave të shpallur;
- h. përcaktimin e mekanizmave për identifikimin e subjekteve potencial për shpallje sipas kriterëve të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;
- i. ndjekjen e procedurave dhe formularëve standardë për listim të miratuara nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së;
- j. vendosjen e procedurave të heqjes nga lista dhe të zhbllokimit të fondeve dhe pasurive të subjekteve të cilët nuk plotësojnë/nuk plotësojnë më, kriteret për shpallje;

Arritja e objektivave të mësipërm realizohet nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (*Financial Action Task Force – FATF*). Zbatimi i rekomandimeve të FATF-së, është detyrim që rrjedh nga Konventa e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit

dhe për financimin e terrorizmit”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646, datë 27.11.2006.

Sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i është nënshtruar disa herë vlerësimeve nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës (organi rajonal që vlerëson për vendin tonë përputhshmërinë me rekomandimet e FATF-së). Në këtë kuadër në datën 10.10.2013 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i cili kishte si qëllim parandalimin dhe goditjen në kohë dhe pa vonesa e veprimtarive të terroristëve dhe e atyre, që mbështesin dhe e financojnë terrorizmin, nëpërmjet marrjes së masave të bllokimit apo sekuestrimit të fondeve e pasurive e tyre.

Gjatë vitit 2018 vendi ynë i është nënshtruar raundit të pestë Vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës, (raporti i publikuar në datën 05 Korrik 2018). Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së.

Me këtë projektligj synohet përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Rekomandimi 6 i FATF, kriteret përkatëse të këtij rekomandimi, elementë të vlerësuar si pjesërisht të përmbushur. Vlen të evidentohet rëndësia e posaçme e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Rekomandimi 6, pasi bën pjesë në grupin rekomandimeve, që konsiderohen si thelbësore në sistemin parandalues dhe goditës ndaj terrorizmit dhe financimit të tij.

III. STANDARTET NDËRKOMBËTARE NË TË CILAT MBËSHTETET NISMA LIGJORE

1. Konventa e Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”.

Neni 13 i Konventës angazhon vendet anëtare që për marrjen e masave legislative dhe masave të tjera të nevojshme për të vendosur një regjim të plotë të brendshëm rregullues dhe mbikëqyrës për të parandaluar pastrimin e parave dhe merr parasysh si duhet standardet e zbatueshme ndërkombëtare, duke përfshirë veçanërisht rekomandimet e miratuara nga Task Force për Veprimin Financiar mbi Pastrimin e Parave (FATF)”.

2. Rekomandimeve Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF)

Rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (*Financial Action Task Force – FATF*), përcaktojnë standartet dhe nxisin zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullatore dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar. Rekomandimet e FATF përcaktojnë masat thelbësore që vendet anëtare të Këshillit të Evropës duhet të parashikojnë me qëllim:

- a. Identifikimin e rreziqeve, zhvillimin e politikave dhe koordinimin e brendshëm;
- b. Ndjekjen e veprave të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- c. Zbatimin e masave parandaluese për sektorin financiar dhe sektorë të tjerë;

- d. Përcaktimin e kompetencave dhe përgjegjësi të qarta për autoritetet kompetente, ligjzbatuese dhe autoritetet mbikëqyrëse;
- e. Rritja e transparencës dhe disponueshmërinë së informacionit për pronarin përfitues;
- f. Lehtësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në veçanti Rekomandimi 6 i FATF parashikon se:

Shtetet duhet të zbatojnë regjimet e sanksioneve financiare të synuara në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me parandalimin dhe goditjen e terrorizmit dhe financimin e tij. Njëkohësisht shtetet duhet të ngrijnë pa vonesë fondet ose pasuritë e tjera të tyre dhe të sigurojnë që asnjë fond ose pasuri tjetër të mos vihet në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të një individi/entiteti:

- a) që është përfshirë në listë si terrorist a person që financon terrorizmin, nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, në mbështetje të rezolutës 1267 (1999) dhe rezolutat e saj pasuese;
- b) të përfshirë në listën e personave të shpallur në bazë të Rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

3. Gjetjet e Komitetit MONEYVAL

Sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është vlerësuar në kuadër të Raundit të 5-të të vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës. Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së.

Në përfundim të vlerësimit nga Komiteti MONEYVAL, është konstatuar se pavarësisht zhvillimeve të konsiderueshme ligjore, vijon të ketë boshllëqe në kuadrin ligjor që rregullon sanksionet financiare specifike të lidhura me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit.

Legjislacioni aktual në fuqi mbi financimin e terrorizmit nuk përcakton veprimet që duhen kryer nga subjektet raportuese në bazë të urdhërit të bllokimit.

Përkufizimi i fondeve dhe pasurive nuk përfshin pasuritë e trupëzuara dhe të patrupëzuara, duket se nuk përfshin shprehimisht burimet ekonomike duke bërë referencë vetëm tek depozitat bankare. Gjithashtu, nuk parashikohet nëse mekanizmi i bllokimit do të shtrihet tek fondet, të cilat nuk janë në pronësi, por janë nën kontrollin e personave të shpallur.

Ligji aktual, nuk përmban ndonjë detyrim të shprehur për të zbatuar drejtpërsëdrejti sanksionet e OKB-së kundër financimit të terrorizmit. Duke qenë se ligji nuk përkufizon konceptin “bllokim” është e paqartë çfarë veprimi do kryhet nga subjekti raportues.

Mungojnë mekanizmat bllokues për rastet e agjencive ligjzbatuese. Vonesat në pasqyrim mund të rezultojnë në njoftim paraprak de facto të personave apo enteve të interesuara.

Nuk parashikohet ndonjë detyrim për ndjekjen e procedurave dhe formularëve standard, siç janë miratuar nga Komitetet relevante.

Nuk ka një parashikim ligjor të posaçëm që cakton procedurat për të kërkuar nga shtete tjera zbatimin e masave në kuadër të mekanizmit të ngrirjes, dhe sigurimin e informacionit identifikues.

Nuk janë detajuar procedurat për zhblokimin e fondeve të personave apo enteve të prekur padrejtësisht si dhe procedurat për paraqitjen e kërkesave për heqje nga lista e personave të shpallur pranë Komiteteve sanksionuese të OKB-së.

Në adresim të gjetjeve të raportit të Komitetit MONEYVAL e në funksion të rritjes së efektivitetit dhe përputhshmërisë të sistemit në parandalim të financimit të terrorizmit dhe zbatim në kohë dhe me efektivitet të masave të kërkuara nga Këshilli i Sigurimit të OKB, janë draftuar dhe shtesat dhe ndryshimet e propozuara nëpërmjet kësaj nisme ligjore.

V. ÇËSHTJE E DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit në Komision propozuesit argumentuan se nëpërmjet ndryshime ligjore të propozuar synohet forcimi i integritetit të sistemit parandalues në vend, siguria në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë; zvogëlimi i rreziqeve të financimit të terrorizmit, nëpërmjet politikave të koordinimit dhe bashkëpunimit, parandalimi i hyrjes së produkteve dhe veprave penale; si edhe të fondeve të mbështetjes së terrorizmit në sektorin financiar ose zbulimi dhe raportimi i tyre.

Amendamentet që përmban ky projektligj janë përpiluar në pasqyrim të gjetjeve të raportit “Moneyval”, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe përputhshmërisë të sistemit në parandalimit e financimit të terrorizmit dhe zbatimit në kohë edhe me efektivitet të masave të kërkuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së.

Relatori i projektligjit u shpreh se: “Sfidat globale bëjnë që shteti të jetë më i përgatitur, në kuptimin e një legjislacioni më konkret, më të qartë dhe me procedura strikte për t’iu përgjigjur kriminalitetit në rritje në rang global. Nga ana tjetër, organizimi strukturor i agjencive ligjzbatuese në rastin konkret, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave apo Agjencia e Administrimit të Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara, bën që të mos mbetemi thjesht në kuadrin e programimit të disa ligjeve të bukura, por të jemi në një fazë të avancuar, sikurse e përsëriti zëvendësministri. Pra, tashmë jemi në fazën e monitorimit, ku nuk na kërkohet thjesht fjalë, por na kërkohen rezultate dhe eficiencë. Rezultatet dhe efienca vijnë vetëm duke përmirësuar paketën ligjore, e cila në këtë rast vjen në zbatim të rekomandimeve FATF-së, të Moneyval-it, por transponon pjesërisht edhe rekomandimet e direktivave të BE-së, sidomos të direktivës së vitit 2015. Edhe pse në fokus, kjo paketë nuk ka në vetvete përfarimin total me legjislacionin e Bashkimit European.

Më lejoni t’ju sqaroj se vetë direktivat e Bashkimit European kanë qenë dinamike vitet e fundit. Është bërë në vitin 2015, por ka pasur një direktivë të re në maj të vitit 2018 dhe jam i bindur që përsëri do të kemi një pasurim të kësaj direktive, gjë që do të na bëjë që në vijim të kemi një transpozim të plotë të kësaj direktive, por është domosdoshmëri që ta

kalojmë menjëherë këtë paketë, e cila ka mjaft risi në vetvete, jo gjëra të shpifura, por të mira, të marra nga partnerët ndërkombëtarë, nga legjislacionet e vendeve Perëndimore, tek të cilat përherë kemi gjetur atë bahçen pjellore ligjore për të marrë ligjet më të mira.

Për këtë paketë jemi konsultuar me grupe të ndryshme interesi, me shoqatën e bankave, me institucione të tjera shtetërore, me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, e cila ka një rol të rëndësishme në konsultimet për këtë paketë, por edhe në zbatimin e kësaj pakete apo edhe për aktorë të tjerë, me noterë, me grupe të tjera interesi, të cilat janë ose subjekte të zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit ose subjekte përfituese indirekte të të mirave të këtij ligji.”

Në shqyrtimin në parim të projektligjit Komisioni diskutoi për ecurinë e deritanishme e zbatimit të ligjit aktual nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar. Në çfarë mase projektligji i ri ka adresuar problematikat e rezultuara nga zbatimi i ligjit aktual, si dhe detyrimet e vendit tonë bazuar në aktet ndërkombëtare të ratifikuara, stadardet e vendosura në rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF).

Gjatë shqyrtimit të projektligjit Komisioni i kushtoi një vëmendje të veçantë nenin 4 të projektligjit i cili shton nenin 10/1, dispozitë e cila trajton masën e “ngrirjes së përkohshme”, të çdo veprimi, ndërmjetësimi, transaksioni, transferte, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, fondi dhe pasurish të tjera të këtyre personave që subjektet, institucionet dhe personat e parashikuar në neni 10, të ligjit (ku përfshihen subjektet bankare, subjektet financiare jobanka; zyrat e këmbimeve valutore; shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre; shërbimet postare që kryejnë shërbime pagesash; bursat; shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimin, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, fondet e pensionit; lojërat e fatit, të çfarëdo forme; avokatët, noterët, ekspertët kontabël të autorizuar të pavarur, kontabilistët e miratuar etj) janë të detyruar që të marrin, menjëherë, pas vendimeve për shpallje personash apo subjektesh nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, organizatave ndërkombëtare ose marrëveshjeve ku Republika e Shqipërisë është palë, të zbatojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa e kushtëzuar procesin me miratimin e akteve të mëtejshme ligjore apo nënligjorë brenda vendit.

Në këtë aspekt Komisioni trajtoi domosdoshmërisë së marrjes së masës dhe ekzistencës së interesit publik dhe të respektimit të parimit të proporcionalitetit ndërmjet propozimiit të paraqitur dhe synimit që kërkohet të arrihet.

Komisioni vlerësoi se mbrojtja e interesit publik dhe e të drejtave të të tjerëve përbën një kriter të plotësuar nga ky projektligj. Rrezikshmëria, që paraqet terrorizmi dhe financimi i terrorizmit për një shoqëri demokratike është botërisht e njohur. Sigurimi i qetësisë së çdo individi, dhe në një koncept më të gjerë i të gjithë shoqërisë, është detyrë e shtetit dhe një nga detyrat më të rëndësishme të tij, sepse me kryerjen e akteve kriminale të rënda dhunohen jo vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut, por edhe vlera të tjera të njohura dhe të mbrojtura nga Kushtetuta. Masat e parashikuara nga ligji janë proporcionale me gjendjen, që e ka diktuar ndërmarrjen e tyre. Marrja e masës së bllokimit të përkohshëm menjëherë me nxjerrjen e vendimit nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së është një mjet efektiv

dhe i nevojshëm për të luftuar terrorizmin dhe financimit të tij dhe në përputhje me standartin e vendosur në Rekomandimin 6 të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF).

Në funksion të qartësisë, Komisioni propozoi një riformulim të ri të këtij neni në krahasim me variantin e propozuar nga Këshilli i Ministrave me qëllim:

- Që të sigurohet harmonizimi i plotë ndërmjet masave kufizuese të parashikuara nga ky ligj;
- Qartësimin e veprimeve që duhet të ndërmarrin subjektet e ligjit por edhe të përgjegjësisë së autoritetit përgjegjës për të mundësuar njoftimin pa vonesë të vendimeve të strukturave përkatëse të OKB-së në rastin e përfshirjes së një personi ose entiteti si financues i terrorizmit;
- Detajimin e zbatimit të këtij neni nëpërmjet delegimit për përcaktimin e rregullave më të detajuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjatë shqyrtimit në Komision u propozuan edhe disa ndryshime të lidhura me harmonizimin me projektligjin “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara” por edhe rregullime të natyrës teknike të cilat kanë si qëllim qartësimin e mëtejshëm të përmbajtjes së projektligjit.

V. RIFORMULIME DHE PROPOZIME PËR RREGULLIME NEN PËR NEN

Komisioni pasi shqyrtoi rekomandimet e Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionit për Sigurinë Kombëtare, u shpreh dakord me rekomandimet e paraqitura prej tyre duke i bërë pjesë të propozimeve si më poshtë:

A. Në nenin 1

- Pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Në pikën 1, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Bllokimi i përkohshëm” është ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve e të pasurive të tjera, për pasuri të luajtshme apo paluajtshme, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj.

- Pika 2 ndryshohet me këtë përmbajtje:

Në pikën 2, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Sekuestrimi” është ndalimi i çdo transaksioni, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, për pasuri të luajtshme apo paluajtshme, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj.

- Pas pikës 3 të shtohet një paragraf 4 si më poshtë:

“4. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. “Ngrirja e përkohshme” është ndalimi i transferimit, shndërrimit, disponimit apo lëvizjes së çfarëdo fondi apo pasurie tjetër të zotëruar apo kontrolluar nga personi apo enti i shpallur ku përfshihen:

- a. Të gjitha fondet apo pasuritë e tjera që zotërohen apo kontrollohen nga personi apo enti i shpallur, dhe jo vetëm ato që mund të lidhen me një kërcënim, përgatitje apo akt terrorist të veçantë; dhe*
- b. Ato fonde apo pasuri të tjera që tërësisht apo pjesërisht zotërohen apo kontrollohen, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, nga personi apo enti i shpallur; dhe*
- c. Fondet apo pasuritë e tjera të rrjedha apo të prodhuara nga fondet apo pasuritë e tjera që zotërohen apo kontrollohen, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, nga personi apo enti i shpallur; si dhe*
- d. Fondet apo pasuritë e personave apo enteve që veprojnë për llogari të, apo sipas orientimeve të, personave apo enteve të shpallur.”*

B. Neni 2

Në këtë nen fjalët “Pas fjalisë së parë, në pikën 4 të nenit 6 shtohen...” të zëvendësohen me fjalët “Pas pikës 4 të nenit 6 shtohet pika 4/1 si më poshtë:...”

C. Pas nenit 2 të shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Në pikën 1 të nenit 7 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në shkronjën “b” fjalët “Zyrën Qëndore të Pasurive të Paluajtshme dhe...” hiqen.

2. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Ç. Neni 4 të ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 si më poshtë:

“Neni 10/1

Ngrirja e përkohshme

- 1. Subjektet, institucionet dhe personat e parashikuar në neni 10, të këtij ligji, si dhe çdo person në Republikën e Shqipërisë, ngrijnë përkohësisht fondet apo asetet e tjera të personave apo enteve të shpallur, në mënyrë të drejtpërdrejtë, sapo marrin dijeni për shpalljen nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,*

organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, pa u kushtëzuar nga nxjerrja e urdhërit të bllokimit të përkohshëm apo vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Ndalohet vënia në dispozicion të personave apo enteve të shpallur nga strukturat përkatëse sipas pikës 1, të këtij neni, të enteve të zotëruara apo kontrolluara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë prej tyre dhe të personave apo enteve që veprojnë për llogari, apo sipas orientimeve të, personave apo enteve të shpallur të fondeve apo pasurive të tjera, burimeve ekonomike, shërbimeve financiare apo të tjera, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pjesërisht apo tërësisht.
3. Ndalohet njoftimi paraprak i personave të shpallur sipas pikës 1 të këtij neni, dhe të interesuar apo prekur sipas pikës 2 të këtij neni për ngrirjen e përkohshme.
4. Të dhënat e plota për rastet e ngrirjes së përkohshme, përfshirë transaksionet e mbetura në tentativë, i njoftohen menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, e cila jep udhëzimet e nevojshme.
5. Vendimet e strukturave përkatëse, sipas pikës 1, të këtij neni, kanë fuqi të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme, i njoftohen zyrtarisht subjekteve të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji si dhe publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.
6. Zbatimi i masës së ngrirjes së përkohshme, vijon deri në daljen e urdhërit të bllokimit nga ministri përgjegjës për financat sipas parashikimeve të këtij ligji.
7. Rregullat dhe procedura më të detajuara për zbatimin e këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

D. Në nenin 7

Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) fjalët “... jo më shumë se 30 ditë pune ...” zëvendësohen me “... jo më shumë se 45 ditë pune ...”.

b) Në fund të fjalisë së dytë shtohet shprehja me këtë përmbajtje:

“si dhe subjekteve të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji”.

DH. Neni 8

- Referuar regullave të teknikës legislative, pika 1 të ndryshohet si më poshtë:
“Pika 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:
4. Ministria përgjegjëse për punët e jashtme, pas marrjes së njoftimit, sipas pikës 3 të këtij neni, informon strukturat përkatëse pranë Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sipas afateve dhe modaliteteve të përcaktuara prej tyre, duke ndjekur format, procedurat dhe/ose kërkesat e strukturave përkatëse në lidhje me

informacionin e kërkuar për identifikimin e personave të shpallur dhe të lidhur me ta, të dhëna për rastin dhe arsyet e propozimit, si dhe nëse statusi i vendit, si propozues, mund të bëhet i njohur. I njëjti standard të dhënash dhe procedure, për aq sa është e zbatueshme, përdoret edhe në rastet kur i kërkohet një vendi tjetër marrja e masave për bllokim të përkohshëm apo sekuestrim, sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje :

- Në pikën 2 shprehja “kur besohet se janë mbledhur prova të mjaftueshme” të zëvendësohet me shprehjen “kur rezulton se ka shkaqe të arsyeshme që krijojnë dyshimin për përfshirjen e personit ose subjektit përkatës për të cilin kërkohet shpallja në vepra të terrorizimit ose të financimit të tij”.

E. Në nenin 9

Ndryshon si më poshtë vijon :

Në pikën 1 dhe 2 fjalët “dhe jo më vonë se brenda 3 ditëve” hiqen

Ë. Pas nenit 9 të shtohet neni 9/1 si më poshtë:

“Neni 9/1

Në nenin 22, pika 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“4. Procedurat dhe rregullat e marrjes në administrim, shpenzimet për administrim dhe kthim të fondeve e pasurive të tjera të sekuestruara, rregullohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”.

F. Neni 11

- Në pikën 2 shkronja “e” fjala “prekur” të zëvendësohet me fjalën “cënuar”.

G. Pas nenit 11 të shtohen nenet 11/1 dhe 11/2 si më poshtë:

“Neni 11/1

Kudo në ligj fjalët “ministri i financave” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për financat, fjalët “ministri i punëve të jashtme” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për punët e jashtme”, fjalët “Ministri i Brendshëm” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike”, fjalët Ministria e Brendshme” zëvendësohen me fjalët “ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike”,

fjalët “Ministri i Drejtësisë” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë”, fjalët “Ministria e Drejtësisë” zëvendësohen me fjalët “ministra përgjegjëse për çështjet e drejtësisë”, fjalët “ministri i mbrojtjes” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes” dhe fjalët “ministra e mbrojtjes” zëvendësohen me fjalët “ministra përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes”.

“Neni 11/2

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 7 të nenit 10/1 të këtij ligjit.

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim: Komisioni e miratoi projektligjin në parim , nen për nen dhe në tërësi duke u shprehur dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATORI

Alket HYSENI

KRYETARI

Ulsi MANJA